



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:258262

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05563284

KF.nr.270/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala dhe zyrtaren ligjore Arta Hyseni, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Garden” Sh.P.K me numër unik identifikues 810525701 me seli në Prishtinë, lagjja “Kalabria” pn, të cilën me autorizim e përfaqëson Bardh Ademaj, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti ndëshkim administrativ, vlera e kontestit 5,500.00 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me 02.04.2024 në prezencë të përfaqësuesit të palës paditëse Bardh Ademaj, e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit “Garden” Sh.P.K., me seli në Prishtinë.
- II. Anulohet vendimi nr.prot.354/2021 i datës 02.10.2020 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë-Departamentit të Ankesave, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 12.11.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.354/2021 të datës 12.10.2021, me të cilin është refuzuar ankesa

e paditësit kundër vendimit për vendosjen e ndëshkimit nr.945/2021 të datës 13.08.2021. Paditësi si në padi dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor të datës 02.04.2024, ka theksuar se mbesin pranë padisë dhe kërkesë padisë si e drejtë dhe e bazuar. Më tej ka theksuar se e kundërshtojnë në tërësi përgjigjen në padi të të paditurës si e paqëndrueshme.

Ka shtuar se lënda e padisë është anulimi i vendimit nr.354/2021 me të cilin paditësi është gjobitur me gjobë me të holla në shumë prej 5,500.00 euro kinse gjatë kontrollit nga ana e inspektorëve të ATK-së paditësi nuk ka lëshuar kuponë fiskal dhe këtë 82 kuponë fiskal, 57 prej tyre në pishinë, 23 në restorant dhe 5 në dhoma të fjetjes. Po ashtu është përcaktuar se i ka 11 punëtor të pa deklaruar e që rezultojnë në mos mbajtjen e dokumentacionit. Më tej ka shtuar se qëndron fakti se nga i padituri është bërë aplikim i gabuar i ligjit përkatësisht neni 21 par 1 pika 1.2 të Udhëzimit administrativ nr. 15/2010 dhe neni 4 pika 1.3 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2015 dhe neni 56.6 të Ligjit 03/L-222. Sipas UA të cekur më lartë paditësi nuk ka obligim të lëshoj kupon fiskal menjëherë me shërbimin e klientit por atë e bënë me rastin e kryerjes së shërbimeve përkatësisht të pagesës nga klientët të vendosur. Ka sqaruar se pjesa dërrmuese e klientëve kanë qenë me pansion të plotë. E paditura nuk ka asnjë provë të mundshme që paditësi nuk ka lëshuar kupon fiskal për secilën tavolinë që ka shërbyer. I padituri ka mund të shqiptojë edhe ndonjë gjobë klientëve nëse nuk janë pajisur me kupon fiskal dhe këtë në vështrim të neni 53.7 të Ligjit nr. 03/L-222, por një gjë nuk ka ndodh, andaj i padituri nuk ka asnjë provë të mundshme që paditësi nuk ka lëshuar kupon fiskal me rastin e dhënies të shërbimeve hoteliere. Po ashtu nuk qëndron fakti se paditësi ka 30 punëtorë të pa lajmëruar pasi që punëtorët pranë vetes nuk mbajnë kontratën, por kontratat janë në shërbimin e paditësit, të cilat nuk janë kërkuar nga i padituri. Andaj nisur nga këto fakte rrethore me rastin konkret kemi të bëjmë me një vendim të kundërligjshëm dhe të pa qëndrueshëm i cili është marrë në kundërshtim me UA të cekur më lart dhe i sanksionuar po ashtu sipas neni 53.6 të Ligjit si më lart. Nga kjo rrjedhë se vendimi i atakuar nuk është i mbështetur fare në prova përkatësisht është bërë interpretim i gabuar i ligjit dhe i dispozitave që e zbatojnë këtë lëmi. Gjykatës i dorëzohet një aktgjykim të Gjykatës Supreme nr.15/19 datë 16.05.2019 e cila ka vendosur për një çështje të natyrës së njëjtë. Pavarësisht kontrollit të kryer nga e paditura me asnjë provë të mundshme nuk është dëshmuar se paditësi ka shërbyer klientë pa kuponë fiskal me përjashtim siç pohojnë për lëshuarjen e kuponit fiskal me rastin e dhënies së çdo shërbimi. Gjykatës i ka propozuar që të anulohet vendimin e atakuar si të padrejtë dhe të paligjshëm. Gjithashtu ka kërkuar shpenzimet e procedurës, për përpilimin e padisë në shumë prej 104 euro për pagesën e takës në shumë prej 50 euro dhe për mbajtjen e seancës në shumë prej 150 euro.

E paditura, në përgjigje në padi të datës 06.03.2023 dhe 29.03.2024, ka deklaruar se vendimi i DA-së nr.354/2021 i datës 12.10.2021 është i drejtë dhe në pajtim me dispozitat e legjislacionit tatimor në fuqi. Tutje shton se Inspektori tatimor ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike në momentin e caktuar, pastaj ZGJONA ka vepruar drejt me rastin e shqiptimit të gjobave dhe Divizioni i Ankesave me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit. Ka sqaruar se ATK-ja pas verifikimit të shkresave në lënde konstaton se paditësi është ndëshkuar në mbështetje të paragrafit 6 të nenit 53 të Ligjit Nr.03/L-222 në vlerë prej 5,000.00 (10\* 500.00 euro) bazuar në vizitën e datës 04.07.2021, për shkak të parregullsive të konstatuara mos-lëshimin e kuponëve fiskal si dhe në vlerë prej 500.00 (1\*500.00 euro), për shkak të parregullsive të konstatuar – mos mbajtje e dokumentacionit mos regjistrimi i të gjithë punëtoreve, duke shtuar se ndëshkimet përkojnë me realiteti e të hyrave dhe janë në përputhje me nenin 53 paragrafi 2.3 respektivisht paragrafi 3, ku baza për llogaritjen e ndëshkimit administrativ është qarkullimi real i vitit aktualë. Ku sipas deklarimeve të biznesit në ATK qarkullimi i vitit 2020 është 468,227.16 euro. Ndërsa në përgjigjen e datës 29.03.2024, ndër të tjera ka deklaruar se DA ka evidentuar se një person V.B. nuk ka qenë i evidentuar në listën e pagave. E paditura ftesën për seancë e ka pranuar me datë 28.03.2024, ndërsa me parashtrësën e datës 02.04.2024, gjykatën e ka njoftuar se nuk do të prezantoj në seancën e datës 02.04.2024 me kërkesë që gjykata të vepron në pajtim me nenin 38 par 5 të LKA-së, duke deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi me kërkesë që të refuzohet ankesa/padia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.354/2021 i datës 12.10.2021 i ATK-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 03.04.2024, ka administruar provat si në vijim: Vendimi kontestues nr. 354/2021 i datës 12.10.2021, Vendimi i ZGJONA nr. 0945/2021 i datës 13.08.2021, Ankesë e datës 14.09.2021, Përgjigje në padi e datës 06.03.2023 dhe 29.03.2024, Kuponët fiskal, Formë për vizita përmbushëse, Listat e pagave për kompaninë: viti 2021, periudha 07 2021 dhe periudha 06 2021, Aktgjykimi ARJ-UZVP nr.15/2019.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, vendimit të zyrës për shqiptimin e gjobave, deklarimeve në padi, shkresave të lëndës, vendimit kontestues, përgjigjes në padi, rezulton se i padituri ka realizuar vizitë me datë 03.07.2021 tek këtu paditësi, dhe se ka shqiptuar gjoba sipas vendimit nr. 0945/2021, i datës 13.08.2021, në shumë prej 5,500.00 euro. Paditësi, ka ushtruar ankesë në departamentin e ankesave në ATK-ë, e për të cilën ankesë, ATK-ja me datë 12.10.2021, ka nxjerr vendimin nr. 354/2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, e ndaj të cilit vendim këtu paditësi me padinë e datës 12.11.2021 ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestues nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes administrative në shqyrtim. Gjykata vlerëson se aktvendimi i atakuar përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij, dhe si i tillë edhe nuk mund të ekzaminohet, e sidomos nëse nuk është konstatuar drejtë gjendja faktike, si dhe kur provat nuk janë të arsyetuara veç e veç dhe të ndërlidhura së bashku, andaj deomos edhe është dashur të anulohet.

Në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor, Gjykata pasi ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e lëndës konstaton se nga konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative dhe provave të theksuara në arsyetimet e vendimeve të paditurës, nuk mund të vërtetohet plotësisht gjendja faktike dhe se ekzistojnë kontradikta në mes konstatimeve të cekura pa i arsyetuar mjaftueshëm me prova konkrete. Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. E paditura në vendimin për vlerësim të ndëshkimeve dhe gjobave 1364/2021, të datës 07.08.2021, ka theksuar se pas realizimit të vizitës përmbushëse të zhvilluar nga inspektorët tatimor ka konstatuar se subjekti këtu paditësi ka bërë shkelje ligjore për mos lëshimin e 87 kuponëve fiskal, prej tyre 57 në pishinë, 20 në restoruan dhe 5 për dhoma të fjetjes si dhe janë konstatuar 11 punëtorë të pa deklaruar që rezultojnë në mos mbajtje të dokumentacionit, andaj edhe bazuar në nenin 53, paragrafi 6, të ligjit 03/L-222, dhe nenit 53, pika 2.3 dhe nenit 103.2, ka shqiptuar 10 gjoba nga 500.00 euro, gjithsej 5000.00 euro, dhe 500 për mos-mbajtje të

dokumentacionit fakt ky i vlerësuar si i drejtë edhe nga departamenti i ankesave në vendimin kontestues nr. 354/2021 i datës 12.10.2021.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata vëren se e paditura në përcaktimin e llojit të gjobës ka aplikuar dispozitën e nenit 53, paragrafi 6, të Ligjit nr. 03/L-222, mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe i cili paragraf lidhet me paragrafin 2, nën paragrafin 2.3 të këtij neni, kur ka përcaktuar gjobën në lartësi prej 500.00 euro për çdo kupon fiskal të pa lëshuar. Tutje në aplikim të paragrafit 2.3, të nenit 53, si më lartë aplikohet edhe paragrafi 3, e i cili përcakton qartë se *“Baza për llogaritjen e ndëshkimit administrativ të paraparë në paragrafin 2. të këtij neni është qarkullimi i vitit të kaluar fiskal. Për bizneset e reja, bazë është qarkullimi real i vitit aktual “*, ndërsa si dëshmi për referencën në qarkullimin vjetor i padituri nuk ka bashkangjitur dëshminë dhe atë Pasqyrën e tatimpaguesit, për të vërtetuar se këtu tatimpaguesi në vitin fiskal 2020 ka pasur qarkullim vjetor mbi 200,000 euro e sipas së cilës ka aplikuar neni 53, par 3, i Ligjit 03/L-222, mirëpo vetëm në përgjigje në padi ka theksuar se qarkullimi i deklaruar është 468,227.16 euro, informatë kjo e cila nuk i është bashkangjitur përgjigjes në padi siç ka pasur për obligim e paditura konform nenit 37 par 3 të Ligjit 03/L-202 për Konfliktet Administrative.

E paditura si në vendimin bazë 945/2021 të datës 13.08.2021, ashtu edhe në vendimin kontestues 354/2021 i datës 12.10.2021, nuk është deklaruar dhe as nuk ka bashkangjitur ndonjë dëshmi konkrete për të vërtetuar faktin se këtu paditësi është recidivist ose jo, e që do të mund të aplikohet neni 43, par 103.3 i UA 15/2010 i cili decidivisht përcakton se: *“Megjithatë, në vizitat e mëvonshme, tatimpaguesi do t’i nënshtrohet një ndëshkimi për secilin kupon që nuk është lëshuar deri në maksimum prej 5,000€ (10,000€ në rastin e një tatimpaguesi me qarkullim prej 500,000€ e më shumë). I njëjti ndëshkim aplikohet në të njëjtën mënyrë në rastin e moslëshimit të kuponit me dorë në një formë të miratuar nga ATK në rast të prishjes së një pajisje apo ndërprerje të energjisë“*. Pra e paditura ka aplikuar nenin 43, par 103.3 të UA 15/2010, pa dëshmuar se ndaj paditësit edhe më parë janë aplikuar ndëshkime për mos lëshim të kuponëve fiskal. Ky kufizim për të paditurën është i nevojshëm ngase nga ky konstatim i saktë i gjendjes faktike rrjedh edhe aplikimi i saktë i të drejtës materiale për zbatim qoftë nën paragrafi 1 ose 2, i paragrafit 103 të nenit 43 të UA 15/2010.

Sipas vendimit kontestues rezulton se sipas gjendjes nga SIGTAS paditësi ka 9 punëtor të paevidentuar për të cilët deklararon se tash kanë filluar të punojnë, ndërsa lidhur me vendimin

kontestues 945/2021 thekson se janë konstatuar 11 punëtorë të pa deklaruar. Megjithatë, në përgjigje në padi të datës 29.03.2024, e paditura ka theksuar se Divizioni i Ankesave sipas listës së pagave vërteton se tatimpaguesi i ka të regjistruar punëtorët përveç një prej tyre – V.B. i cili mungon në listën e pagave dhe për këtë arsye duke u bazuar në kundërvajtjen tatimore ka zbatuar nenin 53 (53.2.3). Konstatimet e tilla kontradiktore e bëjnë edhe më të paqartë vendimin kontestues, kjo për faktin se nga provat e administruara, respektivisht listat e pagave të cilat vet e paditura i ka bashkangjitur si dëshmi për pretendimet e saja, rezulton se punëtori i quajtur V.B., gjendet në listat e pagave për muajin kontestues kur edhe është realizuar vizita përmbushëse.

Të metat e lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj Gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të deklarohet lidhur me të gjeturat si më lartë, të konstatoj saktë gjendjen faktike lidhur me numrin e tavolinave të furnizuara me shërbime e për të cilat nuk janë lëshuar kuptona fiskal e më këtë edhe aplikimit të drejtë të dispozitave ligjore në kuptim të asaj se cili element konstituiv i dispozitës së paragrafit 2, të nenit 53, të Ligjit 03/1-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe nenit 43, par 103, i UA 15/2010 janë përmbushur për të ardhur në shprehje aplikimi i drejtë i ndëshkimit në rastin konkret. Të deklaroj saktë numrin dhe emrat e punëtorëve të cilat pretendon se mungojnë në listën e pagave si dhe të deklarohet nëse paditësi ka qenë i ndëshkuar edhe me herët.

Ligji nr. 03/1-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 53, paragrafi 2. Përcakton se “Çdo person i nga i cili kërkohet të krijojë ose mbajë regjistrime, përfshirë kërkesën për të vendosur numrin fiskal të biznesit në të gjithë kuponët dhe faturat e lëshuara, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe i cili nuk e kryen këtë do t’i nënshtrohet një ndëshkimi administrativ si vijon: 2.1. tatimpaguesi me qarkullim vjetor deri tridhjetëmijë (30,000) Euro, ndëshkim administrativ prej njëqindnjëzetepesë (125) Euro, 2.2. tatimpaguesi me qarkullim vjetor nga tridhjetëmijë (30,000) deri dyqind mijë (200,000) Euro –ndëshkim administrativ prej dyqindpesëdhjetë (250) Euro; 2.3. tatimpaguesi me qarkullim vjetor nga dyqind mijë (200,000) deri pesëqind mijë (500,000) Euro – ndëshkim administrativ prej pesëqind (500) Euro; ose 2.4. tatimpaguesi me qarkullim vjetor prej pesëqind mijë (500,000) dhe më shumë – ndëshkim administrativ prej njëmijë (1,000) Euro”, tutje paragrafi 3, përcakton se “Baza për llogaritjen e ndëshkimit administrativ të paraparë në paragrafin 2. të këtij neni është qarkullimi i vitit të kaluar fiskal. Për bizneset e reja, bazë është qarkullimi real i vitit aktual”.

Tutje paragrafi 6, i këtij neni thekson se “Çdo person i cili kërkohet të vonesë një pajisje elektronike fiskale për regjistrimin e transaksioneve të bëra gjatë aktivitetit të tyre ekonomik dhe

*i cili nuk i lëshon klientit të vet kupon nga pajisja e tillë e fiskalizuar, do të detyrohet për një gjorbë e përcaktuar në përputhje me dispozitat e paragrafit 2. të këtij neni. Në rast të dështimit të pajisjes apo rrymës, duhet të lëshohen kuponët e shkruar me dorë të cilët janë miratuar nga administrata tatimore në vend të kuponit të lëshuar nga një pajisje elektronike fiskale, që i nënshtrohet ndëshkim të përshkruar në këtë paragraf”. UA 15/2010 në nenin 43, ka përcaktuar qartë aplikimin e shumës së ndëshkimeve ashtu që në paragrafin 103.1 shprehimisht rregullohet se “Në rastin e parë të mos-lëshimit të një kuponi nga pajisja e fiskalizuar, tatimpaguesi do të ndëshkohet sikur vetëm një kupon nuk është lëshuar”, ndërsa me paragrafin 103.2 përcakton se “Megjithatë, në vizitat e mëvonshme, tatimpaguesi do t’i nënshtrohet një ndëshkimi për secilin kupon që nuk është lëshuar deri në maksimum prej 5,000€ (10,000€ në rastin e një tatimpaguesi me qarkullim prej 500,000€ e më shumë). I njëjti ndëshkim aplikohet në të njëjtën mënyrë në rastin e moslëshimit të kuponit me dorë në një formë të miratuar nga ATK në rast të prishjes së një pajisje apo ndërprerje të energjisë”*

Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L222 se: “Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”. Ndërsa me nenin 7 par 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parashihet se: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarojnë.” Nga dispozitat ligjore të lartcekura, Gjykata konsideron se barra e provës bie mbi palët ndërgjyqëse.

Gjykata, në përputhshmëri me nenin 43 par 1 të LKA-së, vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative. Me nenin 44 është papapararë se “ 1. Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë.”, ndërsa në par 2. “Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.”

Rrjedhimisht, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë kontest tregtar administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë

së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par. 2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi. Vërejtjet e cekura janë te obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimi për shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori konform nenit 64, të LKA-së.

Nga të cekurat më lart, Gjykata konform nenit neni 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.270/22, datë 02.04.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.